

Shërbimet e SMG Politika Globale e Privatësisë

Data efektive: mars 2018

Kjo Politikë e Privatësisë zbatohet për përpunimin e të dhënave personale nga SMG të grumbulluara përmes këtij uebsajti dhe uebsajteve të tjera, shërbimeve dhe aplikacioneve, duke përfshirë aplikacionet e celularit, në të cilat është publikuar, lidhur apo referuar kjo Politikë e Privatësisë (së bashku, “**Shërbimet e SMG**”). “Të Dhënat personale” janë informacione lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm. Shërbimet e SMG zotërohen dhe/ose operohen nga Service Management Group, LLC, Service Management Group Limited, Service Management Group GK dhe filialet e tyre përkatëse (së bashku, “**SMG**”, “ne” ose “neve”). Kjo Politikë e Privatësisë tregon se si ne grumbullojmë dhe përpunojmë të dhënat tuaja personale.

SHQYRTOJENI ME KUJDES KËTË NJOFTIM TË PRIVATËSISË. Të dhënat tuaja personale do të grumbullohen dhe përpunohen siç përshkruhet në këtë Politikë të Privatësisë.

Nëse nuk e keni bërë një gjë të tillë, shqyrtoni Kushtet e Shërbimit të SMG të cilat përcaktojnë kushtet që drejtojnë përdorimin tuaj të uebsajteve tona, shërbimeve dhe aplikacioneve të celularit (“Shërbimet e SMG”).

NËSE NUK JENI DAKORD ME NDONJË PJESË TË KËSAJ POLITIKE TË PRIVATËSISË OSE ME KUSHTET E SHËRBIMIT, MOS PËRDORNI ASNJË NGA SHËRBIMET E SMG.

- 1. NDRYSHIME TË POLITIKËS SË PRIVATËSISË**
- 2. KATEGORITË E TË DHËNAVE PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA SMG**
- 3. SI E MBLEDHIM INFORMACIONIN DHE QËLLIMET E PËRPUNIMIT**
- 4. BAZAT LIGJORE PËR PËRPUNIMIN**
- 5. SI I PËRDORIM DHE NDAJMË TË DHËNAT PERSONALE**
- 6. RUAJTJA DHE ASGJËSIMI I TË DHËNAVE PERSONALE**
- 7. TË DREJTAT DHE ZGJEDHJET TUAJA NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**
- 8. PASOJAT NËSE NUK JEPNI TË DHËNAT PERSONALE**
- 9. POLITIKA E KUKIVE**
- 10. MENAXHIMI I INFORMACIONIT TË LLOGARISË SUAJ**
- 11. PRIVATËSIA PËR FËMIJËT**
- 12. LIDHJE ME SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA**
- 13. SIGURIA E INFORMACIONIT**
- 14. KONSIDERATA GJEOGRAFIKE DHE TRANSFERIMET E TË DHËNAVE PERSONALE PËRTEJ KUFIRIT**
- 15. SI TË NA KONTAKTONI**
- 16. KONTROLLUESI I TË DHËNAVE DHE PËRGJEGJËSI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE**

1. NDRYSHIME TË KËSAJ POLITIKE TË PRIVATËSISË

Ne do ta përditësojmë vazhdimisht këtë Politikë të Privatësisë kur bëjmë ndryshime që ndikojnë në Politikën e Privatësisë, të tilla si shtimi i shërbimeve dhe aplikacioneve të reja, përmirësimi i shërbimeve tona dhe adresimi i ndryshimeve në teknologji dhe ligje. Data efektive e kësaj Politikë të Privatësisë, e cila tregohet në krye të këtij uebsajti, tregon datën në të cilën Politika e Privatësisë është përditësuar për herë të fundit. SMG do t’ju njoftojë nëse këto ndryshime janë të rëndësishme dhe, kur kërkohet nga ligji në zbatim, ne do të marrim miratimin tuaj. Ky njoftim do të jepet duke publikuar njoftimin e ndryshimeve në uebsajtin tonë ose nëpërmjet aplikacioneve tona.

2. KATEGORITË E TË DHËNAVE PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA SMG

SMG zhvillon kërkime të tregut në emër të kompanive të cilat kanë dëshirë që të kuptojnë më mirë preferencat e konsumatorëve në lidhje me mallrat dhe shërbimet e tyre. Këto kompani janë **“Klientët”** tanë. Ne zhvillojmë anketa në emër të klientëve (së bashku, **“Anketa”**) dhe e përdorim këtë informacion për të kuptuar sjelljen e konsumatorëve, të tilla si ku, kur dhe sa shpesh i vizitojnë konsumatorët dyqanet dhe eksperiencat e tyre gjatë vizitave. Kur merrni pjesë në një anketë ose përdorni Shërbimet e SMG, ne grumbullojmë të dhëna personale që na i jepni në mënyrë vullnetare.

Të dhënat personale që ne grumbullojmë përfshijnë: (1) të dhënat e kontaktit (të tilla si adresa e emailit, numri i telefonit dhe punëdhënësi); (2) të dhënat demografike (të tilla si gjinia, data e lindjes dhe kodi postar); (3) përgjigjet tuaja në anketa në atë masë që informacioni ju identifikon ose lidhet me ju si një person i identifikueshëm individualisht; dhe (4) informacionet që kanë të bëjnë me përdorimin tuaj të shërbimeve të SMG (“Të dhënat e përdorimit”).

Të dhënat e përdorimit që ne mbledhim përfshijnë: (1) adresën e IP-së; (2) serverin e domenit; (3) tipin e pajisjes(ve) s(t)ë përdorur(a) për të marrë shërbimet; (4) statistikat dhe informacionin lidhur me ndërveprimin midis shfletuesit ose pajisjes suaj, të tilla si modeli i pajisjes, operatori/rrjeti, informacioni për jetëgjatësinë e baterisë për të optimizuar kampionimin e vendndodhjes në bazë të jetëgjatësisë së mbetur të baterisë dhe statistikat bazë të përdorimit të pajisjes suaj; (5) GPS-në dhe të dhënat e tjera të vendndodhjes gjeografike në kohë reale kur na lejoni që të marrim informacione përmes parametrave të vendndodhjes (ose të ngjashme) në pajisjen tuaj; (6) uebsajte referuese apo burime të tjera me anë të të cilave qasë shërbimet. Kur merrni pjesë në anketa në linjë, ne mbledhim attribute unike të shumëfishta në lidhje me pajisjen tuaj për qëllime të zbulimit dhe parandalimit të mashtrimit.

3. SI E MBLEDHIM INFORMACIONIN DHE QËLLIMET E PËRPUNIMIT

Ne mbledhim dhe përpunojmë informacionin që na jepni si dhe nga përdorimi juaj i shërbimeve të SMG. Informacioni që ne mbledhim dhe se si e përpunojmë atë varet nga mënyra se si ju i përdorini shërbimet e SMG.

Nga Ju. Ne mbledhim informacion nga ju kur:

- **Plotësoni një anketë:** Ne mbledhim informacionin që ju parashtrojmë në përgjigjet e anketës në lidhje me eksperiencat dhe preferencat tuaj si konsumatorë. Ne mund të kombinojmë informacionin e marrë nga përgjigjet e anketës suaj me informacionin që marrim nga klientët tanë, si informacioni në lidhje me përfshirjen tuaj në programet e besnikërisë së klientëve tanë, që t'i kuptojmë më mirë eksperiencat tuaja si konsumatorë. Gjithashtu, ne mund të kombinojmë informacionin e marrë nga përgjigjet e anketës suaj me informacionin e marrë nga përgjigjet e anketës të përdoruesve të tjerë që të kuptojmë më mirë eksperiencat e përgjithshme të konsumatorit. Kur plotësoni një anketë, informacioni që zgjidhni të na jepni do të përdoret në raporte dhe analiza të tjera të eksperiencave dhe preferencave të konsumatorit për klientët tanë ose për përdorime të tjera mbi të cilat ju njoftojmë në momentin që mbledhim informacionin. Nëse nuk doni që informacioni juaj të përdoret në raporte, analiza ose në mënyra të tjera në të cilat ju janë bërë të ditura, mund të zgjidhni që të mos e plotësoni anketën.
- **Përdorni shërbimet e SMG.** Ne mbledhim automatikisht të dhënat e përdorimit kur ndërveproni me shërbimet e SMG me anë të përdorimit të kukive dhe mjeteve të tjera të grumbullimit të të dhënave. Ne i përdorim këto të dhëna të përdorimit për të lehtësuar komunikimin midis pajisjes suaj dhe sistemeve tona, shpërndarjen e

anketave, sigurimin e integritetin të anketës, për të zbuluar dhe parandaluar mashtrimin, për të zhvilluar kërkime të tregut, për të administruar dhe përmirësuar uebsajtin dhe aplikacionet tona dhe për të analizuar përdorimin dhe përmirësuar e ngritur vlerën e shërbimeve të SMG. Për të mësuar më shumë se si dhe pse ne përdorim kukit dhe mjete të ngjashme të grumbullimit të të dhënave, shikoni seksionin “Politika e kukive” në këtë Politikë të Privatësisë.

- **Parashtroni të dhënat tuaja personale ndërsa përdorni shërbimet e SMG:** Kur parashtroni të dhënat tuaja personale në lidhje me përdorimin e shërbimeve të SMG, të tilla si kur na kontaktoni për ndihmë, informacion ose për të bërë komente në lidhje me eksperiencat tuaja me një nga klientët tanë, ne e mbledhim dhe e analizojmë informacionin që ju parashtroni. Kur i jepni komente SMG-së, informacioni që jepni kontribuon në shërbimet që u ofrojmë klientëve tanë dhe në kërkimet tona të përgjithshme të tregut. Me lejen tuaj, komentet tuaja mund të publikohen në TrumpetRatings.com dhe/ose uebsajtet e klientëve tanë. Kur një informacion i tillë publikohet në një forum publik, si TrumpetRatings.com ose në uebsajte të tjera që shihen nga publiku i përgjithshëm, një informacion i tillë bëhet informacion publik. Ajo që keni shkruar mund të shikohet dhe/ose të grumbullohet nga palë të treta dhe të përdoret nga të tjerë në mënyra që ne nuk mund t'i kontrollojmë ose t'i parashikojmë.
- **Marrja e shërbimeve të SMG përmes kredencialeve të medias sociale:** SMG mund t'ju ofrojë mundësinë që të përdorni shërbimet e rrjeteve sociale (së bashku, “**Media Sociale**”) që të qasni disa shërbime të SMG. Kur zgjidhni që të merrni shërbime të SMG përmes kredencialeve të hyrjes në median sociale, SMG, në varësi nga parametrat e privatësisë tuaj, mund të ketë qasje në informacionin që ju i keni dhënë platformës së medias sociale, si emrin tuaj, adresën e emailit, fotografinë e profilit, postimet, komentet dhe informacionet e tjera që lidhen me llogarinë tuaj të medias sociale. Ne mund ta përdorim këtë informacion për ndonjë nga qëllimet e përshkruara në këtë Politikë të Privatësisë dhe për ndonjë qëllim shtesë për të cilin jeni njoftuar në momentin që është grumbulluar informacioni. Nëse nuk doni që informacioni juaj i medias sociale të ndahet me SMG nga një ofrues i medias sociale, ju nuk duhet të përdorni llogaritë tuaja të medias sociale për të qasur shërbimet e SMG.

Nga klientët tanë. Për disa nga produktet dhe shërbimet tona, klientët tanë mund të na dërgojnë informacion në lidhje me ndërveprimet tuaja me markat, produktet dhe shërbimet e tyre, që mund të përfshijë informacion në lidhje me ndonjë program besnikërie në të cilin jeni regjistruar dhe informacion në lidhje me transaksionet tuaja me klientët tanë. Ne mund ta kombinojmë këtë informacion me informacione të tjera të mbledhura për të përmirësuar kërkimet e tregut që zhvillojmë dhe shërbimet që ne u ofrojmë klientëve tanë.

4. BAZAT LIGJORE PËR PËRPUNIMIN

- 4.1. Ne përpunojmë të dhënat tuaja të kontaktit, të dhënat demografike dhe përgjigjet në anketa kur ju plotësoni një anketë ose përdorni shërbimet e SMG. Ne i përpunojmë këto të dhëna personale bazuar në interesat e arsyeshme të klientëve tanë mbi marrjen e reagimeve nga klientët e tyre për t'i ndihmuar ata në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre në përfitim të klientëve dhe bizneseve të tyre, dhe në bazë të interesave të arsyeshme të SMG në përmirësimin e produkteve, shërbimeve dhe kërkimeve të tregut të SMG, dhe në përgjigjen ndaj kërkesave të përdoruesve për ndihmë ose informacion.
- 4.2. Ne i përpunojmë të dhënat tuaja të përdorimit kur plotësoni një anketë ose përdorni shërbimet e SMG. Ne i përpunojmë këto të dhëna të përdorimit bazuar në zgjedhjen tuaj për të vazhduar me anketën, duke konfirmuar miratimin tuaj për përdorimin e kukive të SMG dhe teknologjive të tjera të grumbullimit të të dhënave. Ju mund ta

tërhiqni miratimin tuaj duke kontaktuar me Përgjegjës të tonë për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të e-mailit në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjës të për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108.

- 4.3. Gjithashtu, ne mund të përpunojmë informacionin që i keni dhënë platformave të medias sociale, në varësi të parametrave tuaja të privatësisë, kur përdorni shërbimet e rrjeteve sociale në lidhje me shërbimet e SMG. Ne e përpunojmë një informacion të tillë në bazë të miratimit tuaj që ju jepni në parametrat e privatësisë të shërbimit të rrjeteve sociale. Ju mund ta tërhiqni miratimin tuaj duke ndryshuar parametrat tuaja të privatësisë që të mos na lejoni më që të përdorim të dhënat e medias tuaj sociale.
- 4.4. Ne e përpunojmë informacionin e marrë nga klientët tanë në lidhje me ndërveprimet tuaja me markat, produktet dhe shërbimet e tyre. Ne e përpunojmë këtë informacion bazuar në interesat e arsyeshme të SMG dhe klientëve të SMG, duke përfshirë përmirësimin dhe rritjen e vlerës së produkteve dhe shërbimeve të SMG dhe klientëve të SMG dhe përmirësimin e kërkimeve të tregut të SMG.

5. SI I PËRDORIM DHE NDAJMË TË DHËNAT PERSONALE

Mënyra se si ne e përdorim dhe ndajmë informacionin që mbledhim ose që na jepni, varet nga mënyra se si ju i përdorini ose i qasni shërbimet e SMG. Kur kërkohet nga ligji, SMG do të pajtohet me kërkesën tuaj që ne të ndërpresim sigurimin e të dhënave personale ndaj palëve të treta.

- **Komunikimi me Ju.** Të dhënat tuaja personale do të përdoren, sipas nevojës, për të menaxhuar marrëdhëniet tona dhe për të komunikuar me ju përmes postës, telefonit, emailit, njoftimeve në celular dhe mesazheve me tekst SMS. Përveçse kur personi që merr pjesë në anketë kërkon shprehimisht komunikim, SMG nuk do të kontaktojë askënd me përjashtim të rastit kur kontaktimi është i nevojshëm për të verifikuar integritetin e anketës, për të shpërndarë anketën, për të dhënë çmime dhe përfitime të fituara si rezultat i marrjes pjesë në anketë ose për të ofruar shërbime për klientin. Megjithatë SMG nuk përdor të dhënat tuaja personale për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, ju duhet të shqyrtoni Politikën e Privatësisë së klientit për të cilin ne po grumbullojmë të dhënat tuaja personale që të përcaktoni nëse ky klient i përdor ato për një qëllim të tillë. Ne mund t'i ndajmë të dhënat tuaja personale me ofruesit e shërbimeve që na ndihmojnë me menaxhimin e marrëdhënies sonë me ju.
- **Kryerja e shërbimeve që kërkoni.** Ne mund t'i përdorim dhe ndajmë të dhënat tuaja personale me qëllim që të kryejmë shërbimet që ju kërkoni apo funksionet që nisni, si për shembull, kur publikoni informacione dhe materiale në tabelat e mesazheve, forume ose në faqet e medias sonë sociale. Për më tepër, kur na jepni leje, ne mund të japim të dhënat tuaja personale me qëllim që t'ju identifikojmë tek çdokush ku dërgoni komunikime përmes shërbimeve të SMG. Për më tepër, ne mund t'i përdorim dhe ndajmë të dhënat tuaja personale me palët e treta për të dhënë çmime dhe për të përmbushur përfitime që ju keni kërkuar dhe fituar duke marrë pjesë në anketa. <}Nëse zgjidhni të merrni pjesë në një lotari ose promovion tjetër, ne ia dërgojmë informacionin tuaj administratorëve të palëve të treta të këtyre promovioneve në mënyrë që ata të mund t'u përgjigjen pyetjeve tuaja ose t'ju kontaktojnë në lidhje me një çmim që fituat ose çështje të tjera në lidhje me promovionin.
- **Analizimi i përdorimit dhe përmirësimi i shërbimeve të SMG.** Ne i përdorim të dhënat personale të mbledhura nga kukit dhe mjetet e tjera të mbledhjes së të dhënave për analitikën e përdorimit, zbulimin e mashtrimit dhe përmirësim të performancës së shërbimeve të SMG. Ne mund të përdorim shërbime analitike të uebsajteve të palëve

të treta për të analizuar se si individët i përdorin shërbimet e SMG, duke përfshirë regjistrimin e klikimeve të miut, lëvizjet e miut, aktivitetin e lëvizjes dhe tekstin që shtypni në kutitë e teksteve me dorë të lirë. Ne e përdorim informacionin e mbledhur nga këto shërbime të palëve të treta për të na ndihmuar që të kuptojmë më mirë se si përdoruesve u duken dhe si i përdorin shërbimet e SMG, për të përmirësuar shërbimet tona dhe për të përmirësuar eksperiencën tuaj si përdorues.

- **Ndarja e të dhënave me ofrues të tjerë të shërbimeve.** Ne mund ta ndajmë informacionin tuaj, duke përfshirë të dhënat personale, me ofrues të tjerë të shërbimeve të cilët ne i përdorim për të kryer funksionet për të cilat i angazhohjmë, si pritës (hosting), për ruajtjen e të dhënave dhe sigurinë. Gjithashtu, ne mund t'i ndajmë të dhënat tuaja personale sipas nevojës për të vënë në funksionim shërbime të tjera të lidhura të SMG, si uebsajte të vlerësimit dhe shqyrtimit të cilat ne operojmë.
- **Ndarja e të dhënave me klientët.** Nëse qasni shërbimet e SMG për të marrë pjesë në një anketë në lidhje me përvojën tuaj konsumatore me njërin nga klientët tanë, ne i ndajmë të dhënat personale që mbledhim nga ju të cilat lidhen me përgjigjet tuaja të anketës me atë klient. Gjithashtu, ne mund t'i përdorim këto të dhëna personale për të kuptuar sjelljen e hulumtimit të tregut dhe për t'i ofruar analitikë të sjelljes së konsumatorit dhe inteligjencë biznesi klientëve tanë. Për informacione në lidhje me mënyrën se si klienti për të cilin po mbledhim të dhënat tuaja personale i përdor, mbron dhe përpunon të dhënat personale, lexoni politikën e privatësisë së atij klienti. Ne dhe klientët tanë mund të kombinojmë gjithashtu lloje të ndryshme të informacioneve, duke përfshirë të dhënat personale të mbledhura nga ne për ju, klienti ynë ose burimet e palëve të treta. SMG mund të përdorë informacionin e kombinuar për secilin prej qëllimeve të përshkruara në këtë Politikë të Privatësisë dhe klientët tanë mund të përdorin informacionin e kombinuar për secilin prej qëllimeve të përshkruara në politikën e tyre të privatësisë.
- **Përputhja me detyrimet ligjore dhe zbatimi i të drejtave ligjore.** Ne mund ta ndajmë gjithashtu informacionin që mbledhim nga ju, sipas nevojës, për të zbatuar të drejtat tona, për të mbrojtur pronësinë tonë ose të drejtat, pronësinë ose sigurinë e të tjerëve apo, sipas nevojës, për të mbështetur auditimin e jashtëm, pajtimin dhe funksionet e drejtimit të korporatës. Ne do t'i japin të dhënat personale, si ta shikojmë të arsyeshme, për t'ju përgjigjur një thirrjeje në gjyq, urdhërimit detyrues të një autoriteti të mbrojtjes së të dhënave ose gjykatësi, procesi ligjor, kërkesë qeveritare ose ndonjë detyrimi tjetër ligjor ose rregullator, në çdo rast ky mund të jetë një entitet jashtë vendit tuaj të banimit. Gjithashtu, ne mund t'i ndajmë të dhënat personale siç duhet për të kërkuar zhdëmtime në dispozicion ose për të kufizuar dëmtime që mund të pësojmë.
- **Transferimi i të dhënave në lidhje me ndryshimet e korporatës.** Ne mund të transferojmë informacionin tuaj, duke përfshirë të dhënat personale, në lidhje me ndonjë riorganizim aktual ose të mundshëm, shkrirje biznesesh, shitje, ndërmarrje të përbashkët, detyrë, transferim, blerje ose ndryshim tjetër të pronësisë apo kontrollit nga ose prej SMG apo ndonjë kompanie filiale (në çdo rast pavarësisht nëse bëhet tërësisht ose pjesërisht), duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me ndonjë falimentim apo procedura të ngjashme. Çdo entiteti të tillë tek i cili transferojmë të dhënat personale do t'i kërkohet që t'ju japë një njoftim për ndonjë qëllim të përpunimit jo të pajtueshëm me qëllimet e përcaktuara në këtë Politikë të Privatësisë, si dhe në ndonjë praktikë të privatësisë që është materialisht e ndryshme nga praktikën e përcaktuara në këtë Politikë të Privatësisë. Kur kërkohet nga ligji, një entiteti të tillë do t'i kërkohet gjithashtu që të marrë miratimin tuaj.

- **Përdorimi i të dhënave personale për qëllime të tjera biznesi.** Ne i përdorim të dhënat tuaja personale gjithashtu për qëllime të tjera të ligjshme biznesi të tilla si zhvillimi i produkteve e shërbimeve dhe administrimi i shërbimeve të SMG.

6. RUAJTJA DHE ASGJËSIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Ne do t'i ruajmë të dhënat tuaja personale në regjistrimet tonë jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat u mbledhën në fillim. Kur një informacion i tillë nuk është më i nevojshëm për qëllimet për të cilat u mbledh në fillim, ne do t'i fshijmë në mënyrë të sigurt të gjitha të dhënat tuaja personale elektronike dhe do të copëtojmë në mënyrë të sigurt ndonjë kopje fizike të të dhënave personale, me përjashtim të atij informacioni që është i nevojshëm për të vepruar në përputhje me detyrimet tona ligjore.

7. TË DREJTAT DHE ZGJEDHJET TUAJA NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ju mund ta ndërprisni pjesëmarrjen në anketa në çdo kohë duke mos patur më qasje në shërbimet e SMG.

Nëse banoni në një vend me ligje ose rregullore që ju japin të drejta për të kërkuar veprime specifike në lidhje me të dhënat tuaja personale, juve do t'ju jepem të drejtat e dhëna nga ai(ato) ligj[e] ose rregull[a], që mund të përfshijnë të drejtën për të kërkuar qasje dhe korrigjim (*p.sh.*, ndryshim ose plotësim) ose fshirje të të dhënave tuaja personale, të drejtën për të transferuar të dhënat tuaja (*p.sh.*, bartja e të dhënave), kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale, si dhe e drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave tuaja personale, të drejtën për të tërhequr miratimin tuaj, të drejtën për të anuluar llogarinë tuaj dhe të drejtën për të paraqitur një ankesë te një autoritet mbikëqyrës. Të gjitha këto kërkesa do të trajtohen në përputhje me treguesit e përcaktuar nga ligji dhe rregulloret në zbatim.

Nëse banoni në Bashkimin Evropian, ju keni, në bazë të Rregullores mbi Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme, të drejtën që të kërkonit nga SMG qasjen dhe korrigjimin ose fshirjen e të dhënave tuaja personale, bartjen e të dhënave, kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale, të drejtën e kundërshtimit të përpunimit të të dhënave tuaja personale, të drejtën e tërheqjes së miratimit tuaj dhe të drejtën për të paraqitur një ankesë te një autoritet mbikëqyrës. Nëse nuk banoni në Bashkimin Evropian, ju mund të keni gjithashtu disa të drejta lidhur me të dhënat në bazë të ligjeve lokale.

Që të bëni një kërkesë të tillë, kontaktoni me Përgjegjës tonë për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108.

8. PASOJAT NËSE NUK JEPNI TË DHËNAT PERSONALE

Megjithëse pjesëmarrja në anketat tona është vullnetare, ju mund të mos kualifikoheni për programe të caktuara, shpërblime ose përfitime nëse nuk na jepni të gjithë informacionin e kërkuar nga anketa.

9. POLITIKA E KUKIVË

9.1. Çfarë janë kukit

SMG dhe ofruesit tanë të shërbimit përdorin skedarë të vegjël teksti të quajtura kuki. “**Kukit**” janë skedarë të vegjël kompjuteri që dërgohen ose merren nga shfletuesi juaj i uebit apo disku i ngurtë i kompjuterit, pajisjes celulare ose tabletit tuaj të cilët përmbajnë informacione në lidhje

me kompjuterin tuaj, të tillë si ID-ja e përdoruesit, parametrat e përdoruesit, historinë e shfletimit dhe aktivitetet e kryera gjatë përdorimit të Shërbimeve. Një kuki zakonisht përmban emrin e domenit (vendndodhjen e internetit) nga e cila kuki u krijua, "jetëgjatësinë" e kukit (p.sh. kur skadon) dhe një numër ose identifikues unik të krijuar rastësisht. Kudit mund të lidhen me të dhënat personale.

9.2. Si i përdorim kukit dhe mjetet e mbledhjes së të dhënave

Kudit na ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve të SMG përmes ndjekjes së zakoneve tuaja të navigimit dhe duke përshtatur eksperiencën tuaj me shërbimet e SMG. Kjo na lejon që të analizojmë informacionin teknik dhe të navigimit në lidhje me shërbimet e SMG dhe na ndihmon që të zbulojmë dhe parandalojmë mashtrimin.

Gjithashtu, ne përdorim kukit dhe mjetet e tjera të mbledhjes së të dhënave (si sinjalizimet e uebit dhe evidencat e serverit), të cilave u referohemi si **"Mjete të Mbledhjes së të Dhënave,"** për të ndihmuar në përmirësimin e eksperiencës suaj me shërbimet e SMG – për shembull, duke ju mbajtur mend kur ktheheni përsëri për të na vizituar dhe duke e bërë përmbajtjen që shikoni më të përshtatshme për ju.

Shërbimet e SMG mund të përdorin gjithashtu mjetet e mbledhjes së të dhënave për të grumbulluar informacione nga pajisja që përdorni për të qasur shërbimet e SMG, të tilla si tipi i sistemit tuaj operativ, tipi i shfletuesit, domeni dhe parametrat e tjera të sistemit, si dhe gjuhën që përdor sistemi juaj dhe vendin e zonën kohore në të cilën ndodhet pajisja juaj.

9.3. Kontrolli juaj mbi kukit

Shfletuesit e uebit ju lejojnë një farë kontrolli mbi shumicën e kukive përmes parametrave të shfletuesit. Disa shfletues të uebit (duke përfshirë shfletuesit e uebit të celularit) ofrojnë parametra që ju lejojnë që të refuzoni kukit apo që t'ju njoftojnë kur një kuki vendoset në kompjuterin, tabletin ose pajisjen tuaj celulare. Ju mund të keni mundësinë që të refuzoni identifikuesit e pajisjes duke aktivizuar parametrin e përshtatshëm në pajisjen tuaj celulare. Megjithëse nuk ju kërkohet që të pranoni kukit ose identifikuesit e pajisjes celulare të SMG, nëse i bllokoni ose i refuzoni ato, ju mund të mos jeni në gjendje që të keni qasje në të gjitha tiparet në dispozicion përmes shërbimeve të SMG. Për më tepër, nëse banoni në një juridiksion që na kërkon të sigurojmë miratimin tuaj për përdorimin e kukive në uebsajtet dhe/ose aplikacionet tona, ju do të keni një mundësi që të menaxhoni preferencat tuaja për kukit në ato uebsajte dhe/ose aplikacione; përveçse disa kuki kërkohen që të lejohet funksionaliteti kryesor i uebsajteve dhe aplikacioneve të tilla dhe ju nuk mund të zgjidhni që t'i çaktivizoni ato.

10. MENAXHIMI I INFORMACIONIT TË LLOGARISË SUAJ

Ju mund të vizitoni seksionin e llogarisë së shërbimit përkatës të SMG për të menaxhuar dhe korrigjuar pasaktësitë faktike në informacionin që ne kemi për ju. Nëse keni pyetje në lidhje me qasjen ose korrigjimin e të dhënave tuaja personale, kontaktoni me Përgjegjësin tonë për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108.

11. PRIVATËSIA PËR FËMIJËT

Shërbimet e SMG janë të destinuara për audiencën e përgjithshme dhe nuk i drejtohen fëmijëve që janë nën moshën në të cilën ata mund të japin miratimin për përpunimin e të dhënave të tyre personale në ndonjë juridiksion ku ata veprojnë. Ne nuk grumbullojmë me vetëdije të dhëna personale nga persona të tillë. Nëse merrni informacion se një fëmijë nën

moshën në të cilën ai/ajo mund të japë ligjërisht miratimin për përpunimin e të dhënave të tij/saj personale, na ka ofruar të dhëna personale pa miratimin nga prindi, kontaktoni me Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave me email në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108. Nëse merrni informacion se një fëmijë nën moshën në të cilën ai/ajo mund të japë miratimin për përpunimin e të dhënave të personale në juridiksionin e tij/saj, na ka dhënë të dhëna personale pa miratimin nga prindi, ne ndërmarrim hapa për të hequr një informacion të tillë dhe e mbyllim llogarinë e fëmijës sa më shpejt që të jetë e mundur.

12. LIDHJE ME SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA

Shërbimet e SMG mund të përmbajnë lidhje me uebsajte dhe shërbime të palëve të treta (“**Shërbime të palëve të treta**”) me të cilat SMG nuk ka ndonjë lidhje. Një lidhje me ndonjë shërbim të palëve të treta nuk do të thotë se ne e mbështesim atë ose cilësinë apo saktësinë e informacionit të paraqitur në të. Nëse vendosni të vizitoni një shërbim të palëve të treta, ju i nënshtroheni praktikave të tyre të privatësisë dhe jo praktikave të privatësisë të përcaktuara në këtë Politikë të Privatësisë.

13. SIGURIA E INFORMACIONIT

SMG ka një program për sigurinë e informacionit i cili zbaton masa teknike, fizike dhe organizuese të projektuara për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale; mbrojtjen ndaj kërcënimeve të parashikuara të konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërinë e të dhënave personale; dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja personale nga humbja, keqpërdorimi, ndryshimi i paautorizuar dhe shkatërrimi, dhe qasja e paautorizuar dhe nxjerrja e tyre.

Megjithatë, kur të dhënat personale përpunohen, ka një rrezik që të dhëna të tilla të mund të humbasin, keqpërdoren, ndryshohen, vidhen, shkelen, dhe/ose qasen nga një palë e tretë e paautorizuar. Asnjë sistem ose transmetim në linjë i të dhënave nuk është plotësisht i sigurt. Përveç masave teknike, fizike dhe organizative që SMG ka në zbatim për të mbrojtur të dhënat tuaja personale, ju duhet të përdorni masa të përshtatshme sigurie për të mbrojtur të dhënat tuaja personale. Nëse mendoni se llogaria juaj e SMG ose ndonjë informacion që na keni dhënë nuk është më i sigurt, njoftoni menjëherë Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com ose duke na telefonuar në 1-800-764-0439 dhe duke kërkuar që të flisni me Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave të SMG.

14. KONSIDERATA GJEOGRAFIKE DHE TRANSFERIMET E TË DHËNAVE PERSONALE PËRTEJ KUFIRIT

SMG i kontrollon dhe operon shërbimet e SMG nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. SMG mund t'i transferojë, ruajë dhe përpunojë të dhënat tuaja personale në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Japoni ose vend tjetër në Azi ose në Bashkimin Evropian. Mbani parasysh se ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë së vendit në të cilin po transferohen të dhënat tuaja personale mund të mos jenë aq gjithëpërfshirëse sa ligjet në vendin tuaj. Për shembull, të dhënat personale të transferuara në Shtetet e Bashkuara mund t'i nënshtrohen kërkesave të ligjshme të qasjes nga autoritetet federale dhe shtetërore në Shtetet e Bashkuara.

Çdo transferim i të dhënave personale nga Zona Ekonomike Evropiane (“EEA”) në Shtetet e Bashkuara kryhet në përputhje me Mburojën e Privatësisë BE-SHBA. SMG merr pjesë dhe pajtohet me parimet e Mburojës së Privatësisë BE-SHBA A lidhur me grumbullimin, përdorimin, ndarjen dhe ruajtjen së të dhënave personale nga EEA, siç përshkruhet në certifikatën e Mburojës sonë të Privatësisë BE-SHBA. Shikoni listën e Mburojës së Privatësisë [këtu](#).

Mësoni më shumë rreth Mburojës së Privatësisë [këtu](#). SMG i nënshtrohet mbikëqyrjes së Komisionit Tregtar Federal të SHBA, dhe do të mbetet përgjegjës për përpunimin e të dhënave personale në një mënyrë që nuk pajtohet me Parimet e Mburojës së Privatësisë nga palët e treta të cilave SMG u ka transferuar të dhëna personale përveçse kur SMG vërteton se nuk është përgjegjëse në ndonjë mënyrë për ngjarjen që shkaktoi dëmin. Të gjitha transferimet e tilla të të dhënave personale jashtë EEA do të jenë në përputhje me Politikën e Privatësisë dhe të gjitha ligjet e zbatueshme. Nëse keni ndonjë ankesë në lidhje me pajtimin tonë me Mburojën e Privatësisë, kontaktoni me Përgjegjësën tonë për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108. Gjithashtu, ju mund t'i paraqitni një ankesë, pa pagesë, trupit tonë të pavarur të caktuar për zgjidhjen e konflikteve, Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit, dhe në disa rrethanë, të kërkonti nisjen e procesit të arbitrazhit të Mburojës së Privatësisë.

Politika e Privatësisë në gjuhën angleze është deklarata zyrtare e SMG mbi praktikën e saj të privatësisë në lidhje me shërbimet e SMG. Në rast të ndonjë papajtueshmërie midis asaj Politike të Privatësisë në gjuhën angleze dhe ndonjë përkthimi në ndonjë gjuhë tjetër, do të mbizotërojë dokumenti në gjuhën angleze.

Ju gjithashtu mund t'i referoheni një ankese falas, tek organizmi ynë i zgjedhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, Shoqata Amerikane e Arbitrazhit (<http://go.adr.org/privacyshield.html>), dhe në rrethana të caktuara, thirrni procesin e arbitrazhit të Mbrojtjes së Privatësisë.

15. SI TË NA KONTAKTONI

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me privatësinë, keni nevojë për ndihmë me qasjen ose përditësimin e të dhënave tuaja personale ose keni ankesa në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale, kontaktoni me Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com.

Gjithashtu, mund të na shkruani në:

Service Management Group, LLC
Për: Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave
1737 McGee Street
Kansas City, MO 64108

Service Management Group, Ltd.
Për: Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave
38-40 The Maltings
St Albans
Hertfordshire AL1 3HL
UNITED KINGDOM

Service Management Group G.K.
Për: Përgjegjësën për Mbrojtjen e të Dhënave
2-7-16 No. 3 Komoriya Building 9F
Hamamatsu-cho, Minato-ku
Tokyo 1050013, Japan

16. KONTROLLUESI I TË DHËNAVE DHE PËRGJEGJËSI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE

Të dhënat personale të mbledhura nga SMG kontrollohen nga Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108. Ju mund të kontaktoni me Përgjegjësën

tonë për Mbrojtjen e të dhënave me anë të emailit në privacyofficer@smg.com ose duke i shkruar Përgjegjësit për Mbrojtjen e të Dhënave, Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108.